



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (QRK) NR. 09/2018 PËR STANDARDE MINIMALE TË AFTËSISË PSIKO
FIZIKE PËR SHOFRË TË AUTOMJETEVE¹**

**ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (GRK) NO. 09/2018 ON MINIMAL STANDARDS OF PSYCHOPHYSICAL
SKILLS FOR DRIVERS OF THE VEHICLES²**

**ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO (VRK) BR. 09/2018 O MINIMALNIM STANDARDIMA PSIHOFIZIČKE
SPOSOBNOSTI ZA VOZAČE MOTORNIH VOZILA³**

¹Udhëzim Administrativ (QRK) NR. 09/2018 për Standarde Minimale të Aftësisë Psiko Fizike për Shoferë të Automjeteve është miratuar në mbledhjen e 42 të Qeverisë së Republikës së Kosovës me vendimin numër Nr.04/42, me date 19.04.2018

² Administrative Instruction (GRK) NO. 09/2018 on Minimal Standards of Psychophysical Skills for Drivers of the Vehicles was approved on 42 meeting of the Government of the Republic of Kosovo with the decision No.04/42, date 19.04.2018

³ Administrativno Uputstvo (VRK) BR. 09/2018 o Minimalnim Standardima Psihofizičke Sposobnosti za Vozače Motornih Vozila osvojen je na 42 sednice Vlade Republike Kosova, odluku Br.04/42, od 19.04.2018

<p>Qeveria e Republikës së Kosovës,</p> <p>Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 77 dhe 81 të Ligjit nr. 05/L-064 për Patentë Shoferi (GZ Nr. 17 / 10 qershor 2016), si dhe nenit 19 (6.2) Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 (GZ nr.15, 12.09.2011),</p> <p>Miraton:</p> <p>UDHËZIM ADMINISTRATIV (QRK) NR. 09 /2018 PËR STANDARDE MINIMALE TË AFTËSISË PSIKO FIZIKE PËR SHOFERË TË AUTOMJETEVE</p> <p style="text-align: center;">Neni 1 Qëllimi</p> <p>1. Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim të përcaktoj standardet minimale të aftësive psiko –fizike të nevojshme për drejtimin e automjetit për kandidatin i cili aftësohet për marrjen dhe vazhdimin e patentë shoferit, lëshimin e certifikatave shëndetësore, dhe kryerja e ekzaminimeve mjeksore.</p> <p>2. Ky Udhëzim Administrativ është në pajtueshmëri me Direktivën Evropiane 2006/126 për Patentë Shoferë, datë 20 dhjetor 2006 dhe Direktivën Evropiane 2009/113 të</p>	<p>Government of Republic of Kosovo,</p> <p>Pursuant to Article 93 (4) of the Constitution of the Republic of Kosovo, in accordance with article 77 and 81 of the Law No. 05/L-064 on Driving License (OG No. 17/10 June 2016), and article 19 (6.2) of the Government Rules of No. 09/2011 of (OG no.15, 12.09.2011),</p> <p>Approves:</p> <p>ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (GRK) NO. 09 /2018 ON MINIMAL STANDARDS OF PSYCHOPHYSICAL SKILLS FOR DRIVERS OF THE VEHICLES</p> <p style="text-align: center;">Article 1 Purpose</p> <p>1. This Administrative Instruction aims to determine the minimum standards of necessary psychophysical skills of a candidate to drive the vehicle and who is qualified to obtain and renew the driving license, obtain health certificate, and conduct medical examination.</p> <p>2. This Administrative Instruction is in compliance with the European Directive 2006/126 on Driving Licenses, dated 20 December 2006, and the European Directive</p>	<p>Vllada Republike Kosovo,</p> <p>Na osnovu člana 93 (4) Ustava Republike Kosovo, u skladu sa članom 77 i 81 Zakona br. 05/L-64 o Vozačkoj Dozvoli (SL br. 17/10. jun 2016.), i sa članom 19 (6.2) Pravilnika o Radu Vlade br. 09/2001 (SL br. 15, 12.09.2001),</p> <p>Usvaja:</p> <p>ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO (VRK) BR. 09/2018 O MINIMALNIM STANDARDIMA PSIHOFIZIČKE SPOSOBNOSTI ZA VOZAČE MOTORNIH VOZILA</p> <p style="text-align: center;">Član 1 Cilj</p> <p>1. Cilj ovog Administrativnog uputstva je da utvrdi minimalne standarde psihofizičke sposobnosti potrebnih za upravljanje vozilom za kandidata koji pohađa obuku za dobijanje ili produženje vozačke dozvole, izdavanje lekarskih uverenja i vršenje lekarskih pregleda.</p> <p>2. Ovo Administrativno uputstvo je u skladu sa Evropskom direktivom 2006/126 o vozačkim dozvolama, od 20. decembra 2006. i Evropskom direktivom 2009/113 od 26.</p>
--	---	--

<p>datës 26 gusht 2009 për plotësimin dhe ndryshimin e Direktivës Evropiane 2006/126 për Patentë Shoferë si dhe me Direktivën Evropiane 2016/1106 të datës 7 korrik 2016 për plotësimin dhe ndryshimin e Direktivës Evropiane 2006/126 për Patentë Shoferë.</p>	<p>2009/113, dated 26 August 2009 on amending and supplementing the European Directive 2006/126/EC on Driving Licences and with European Directive 2016/1106, dated 7 July 2016 on amending and supplementing the European Directive 2006/126 on Driving Licenses.</p>	<p>avgusta 2009. o izmeni i dopuni Evropske direktive 2006/126 o vozačkim dozvolama kao i sa Evropskom direktivom 2016/1106 od 7. jula 2016. o izmeni i dopuni Evropske direktive 2006/126 o vozačkim dozvolama.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 2 Fusha e zbatimit</p>	<p style="text-align: center;">Article 2 Implementation scope</p>	<p style="text-align: center;">Član 2 Oblast primene</p>
<p>Dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ zbatohen nga institucionet e Republikës së Kosovës, institucionet e autorizuar, kandidatët për marrjen dhe vazhdimin e patentë shoferit.</p>	<p>The provisions of this Administrative Instruction shall be implemented by the institutions of the Republic of Kosovo, Authorized Institutions, candidates for obtaining and renewing the driving license.</p>	<p>Odredbe ovog Administrativnog uputstva se sprovode od strane institucija Republike Kosova, ovlašćenih institucija, kandidata za dobijanje i produženje vozačke dozvole.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 3 Klasifikimi i shoferëve</p>	<p style="text-align: center;">Article 3 Classification of drivers</p>	<p style="text-align: center;">Član 3 Klasifikacija vozača</p>
<p>1. Kandidatët dhe shoferët që ngasin automjetin në trafikun rrugorë në bazë të këtij Udhëzimi Administrativ klasifikohen në dy grupe:</p> <p>1.1. Grupi i parë (1): shoferët e automjeteve të kategorive AM, M, A1, A2, A, B1, B, BE, L dhe T , dhe</p> <p>1.2. Grupi i dytë (2): shoferët e automjeteve të kategorive C, CE, C1, C1E,</p>	<p>1. Pursuant to this Administrative Instruction, the candidates and drivers operating a vehicle in road traffic are classified into two groups:</p> <p>1.1. First group (1): drivers of vehicle categories AM, M, A1, A2, A, B1, B, BE, L and T, and</p> <p>1.2. Second group (2): drivers of vehicle categories C, CE, C1, C1E, D, DE, D1 and</p>	<p>1. Kandidati i vozači koji upravljaju vozilom u drumskom saobraćaju, na osnovu ovog Administrativnog uputstva, klasifikuju se u dve grupe:</p> <p>1.1. Prva grupa (1): vozači motornih vozila kategorije AM, M, A1, A2, A, B1, B, BE, L i T, i</p> <p>1.2. Druga grupa (2): vozači motornih vozila kategorije C, CE, C1, C1E, D, DE,</p>

<p>D, DE, D1 dhe D1E si dhe shoferët e automjeteve të kategorisë AM, M, A1, A2, A, B1 dhe B, që drejtuesit e automjetit e kanë profesion themelor (automjetet taxi, auto-ambulancat, etj.).</p> <p>2. Kandidati i cili merr patentë shoferin për herë të parë apo shoferi që vazhdon patentë shoferin klasifikohen në grupin të cilit i takojnë pas marrjes apo vazhdimit të patentë shoferit.</p>	<p>D1E as well as drivers of vehicle categories AM, M, A1, A2, A, B1 and B, whose primary profession is driving (taxi vehicles, ambulances, etc.).</p> <p>2. A candidate who obtains a driving license for the first time or the driver who renews the driving license are classified in the group where they belong after obtaining or renewing the driving license.</p>	<p>D1 i D1E kao i vozači motornih vozila kategorije AM, M, A1, A2, A, B1 i B, kojima je upravljanje vozilom osnovna profesija (taksi vozila, auto-ambulante, itd.).</p> <p>2. Kandidat koji dobija vozačku dozvolu po prvi put ili vozač koji produžava vozačku dozvolu, klasifikuju se u grupi kojoj pripadaju nakon dobijanja ili produženja vozačke dozvole.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 4 Ekzaminimet mjekësore</p>	<p style="text-align: center;">Article 4 Medical examinations</p>	<p style="text-align: center;">Član 4 Lekarski pregledi</p>
<p>1. Kandidati dhe shoferi duhet t'i nënshtrohet ekzaminimeve / kontrollit mjekësor, me rastin e marrjes dhe vazhdimit të patentë shoferit.</p> <p>2. Ekzaminimi mjekësor nënkupton kontrollin mjekësor i cili përfshinë: anamnezën, ekzaminimin fizik sipas sistemeve, vlerësimin e analizave laboratorike, analizat tjera dhe dhënien e konstatimit mjekësor.</p> <p>3. Ekzaminimet mjekësore që duhen t'i nënshtrohen kandidatët për shofer për kategorinë përkatëse dhe për shoferët që vazhdojnë patentë shoferin janë të përcaktuar</p>	<p>1. The candidate and the driver must undergo medical examinations/checks, when obtaining and renewing the driving license.</p> <p>2. Medical examination means medical check which includes: anamnesis, physical examination by systems, review of laboratory analyses of laboratory tests, other analyses and provision of medical ascertainment.</p> <p>3. Medical examinations that should be undergone by the candidates for driving license for the respective category and for drivers that are renewing the driving license,</p>	<p>1. Kandidat i vozaç moraju da se podvrgnu lekarskom pregledu/kontroli, prilikom dobijanja i produženja vozačke dozvole.</p> <p>2. Lekarski pregled podrazumeva lekarsku kontrolu koja obuhvata: anamnezu, fizikalni pregled po sistemima, procenu laboratorijskih analiza, drugih analiza i davanje lekarskog mišljenja.</p> <p>3. Lekarski pregledi kojima moraju da se podvrgnu kandidati za vozača za odgovarajuću kategoriju i za vozače koji produžavaju vozačku dozvolu, su utvrđeni u aneksu 1 ovog</p>

<p>në shtojcën 1 të këtij Udhëzimi Administrativ.</p> <p style="text-align: center;">Neni 5 Kandidat të cilët duhet t'i nënshtrohen ekzaminimit mjekësor</p> <p>1.Përveç kandidatëve për shoferë dhe shoferëve të cilët aplikojnë për vazhdim të patentë shoferit, ekzaminimit shëndetësore duhet t'i nënshtrohen edhe:</p> <p>1.1. shoferët të cilët aplikojnë për kthim të patentës së shoferit të tyre që iu është revokuar për arsye shëndetësore;</p> <p>1.2. shoferi i cili paraprakisht ka kufizime me rastin e lëshimit të patentës së shoferit;</p> <p>1.3. shoferi i përfshirë në aksident të trafikut me fatalitet ose që e ka drejtuar automjetin nën ndikim të alkoolit, të drogës ose të barnave, përbërja e të cilave ndikon negativisht në aftësitë e shoferit;</p> <p>1.4. kandidatët për instruktorë të shoferëve dhe për pyetës të drejtimit(ngasjes).</p>	<p>are set out in Annex 1 of this Administrative Instruction.</p> <p style="text-align: center;">Article 5 Candidates who must undergo medical examination</p> <p>1. Besides candidates for drivers and drivers who apply to renew driving license, health examinations must undergo also:</p> <p>1.1. drivers who apply for the return of their driving licence that has been revoked for health reasons;</p> <p>1.2. driver who have had preliminary restrictions during the issuance of driving licence;</p> <p>1.3. driver involved in traffic accidents with fatality or have driven the vehicle under the influence of alcohol, drugs or medicines whose composition negatively affects in driver's skills;</p> <p>1.4. candidates for instructors of drivers and for driving examiners.</p>	<p>Administrativnog uputstva.</p> <p style="text-align: center;">Član 5 Kandidati koji moraju da se podvrgnu lekarskom pregledu</p> <p>1. Pored kandidata za vozača i vozača koji se prijavljuju za produžavanje vozačke dozvole, lekarskom pregledu moraju se podvrgnuti i:</p> <p>1.1. vozači koji se prijavljuju za povraćaj njihove vozačke dozvole koja im je oduzeta zbog zdravstvenih razloga;</p> <p>1.2. vozač koji prethodno ima ograničenja prilikom izdavanja vozačke dozvole;</p> <p>1.3. vozač koji je učestvovao u saobraćajnoj nesreći sa fatalnim ishodom ili koji je upravljao vozilom pod dejstvom alkohola, droge ili lekova, čiji sastav negativno utiče na sposobnosti vozača;</p> <p>1.4. kandidati za instruktora vozača i za ispitivača upravljanja (vožnje).</p>
<p style="text-align: center;">Neni 6 Certifikata shëndetësore për patentë shoferi</p> <p>1.Certifikata shëndetësore për patentë shofer</p>	<p style="text-align: center;">Article 6 Health certificate for driving license</p> <p>1. Health certificate for driving license is</p>	<p style="text-align: center;">Član 6 Lekarsko uverenje za vozačku dozvolu</p> <p>1. Lekarsko uverenje za vozačku dozvolu se</p>

<p>lëshohet për të gjitha kategoritë.</p> <p>2. Formën dhe përmbajtjen e certifikates shëndetësore për patentë shofer e përcakton Ministria e Shëndetësisë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 7 Komisioni për lëshimin e certifikates shëndetësore</p> <p>1. Certifikata shëndetësore për patentë shofer për kategoritë e grupit të parë sië është përcaktuar në nenin 3 të këtij Udhëzimi Administrativ lëshohet pas ekzaminimit nga komisioni mjekësor në përbërje;</p> <p>1.1. doktori i mjekësisë (mjekë i përgjithshëm) ose specialist i mjekësisë familjare;</p> <p>1.2. oftalmologu;</p> <p>1.3. neurologu/neuropsikiatri;</p> <p>1.4. psikiatri/neuropsikiatri;</p> <p>1.5. psikologu;</p> <p>1.6. otorinolaringologu.</p> <p>2. Certifikata shëndetësore për patentë shofer për kategoritë e grupit të dytë lëshohet pas</p>	<p>issued for all categories.</p> <p>2. The form and content of health certificate for driving license is determined by the Ministry of Health.</p> <p style="text-align: center;">Article 7 Commission for issuance of health certificate</p> <p>1. Health certificate for driving license for first group categories, as defined in Article 3 of this Administrative Instruction is issued after examination by the medical commission in composition of;</p> <p>1.1. doctor of medicine (Doctor of general practice) or specialist of family medicine;</p> <p>1.2. ophthalmologist;</p> <p>1.3. neurologist / neuropsychiatrist;</p> <p>1.4. psychiatrist / neuropsychiatrist;</p> <p>1.5. psychologist.</p> <p>1.6. Othorino-laringologist.</p> <p>2. Health certificate for driving license for the categories of second group is issued after</p>	<p>izdaje za sve kategorije.</p> <p>2. Ministarstvo zdravstva određuje oblik i sadržaj lekarskog uverenja za vozačku dozvolu.</p> <p style="text-align: center;">Član 7 Komisija za izdavanje lekarskog uverenja</p> <p>1. Lekarsko uverenje za vozačku dozvolu, za kategorije prve grupe kako je definirano u članu 3 ovoga Administrativnog Upustva, izdaje se nakon pregleda od strane lekarske komisije u sastavu;</p> <p>1.1. doktor medicine (doktor opšte prakse) ili specijalista porodične medicine;</p> <p>1.2. oftamolog;</p> <p>1.3. neurolog/neuropsihijatar;</p> <p>1.4. psihijatar/ neuropsihijatar;</p> <p>1.5. psiholog.</p> <p>1.6. Othorino-laringologist.</p> <p>2. Lekarsko uverenje za vozačku dozvolu, za kategorije druge grupe, izdaje se nakon</p>
---	---	--

<p>ekzaminimit nga komisioni mjekësor dhe analizave laboratorike.</p> <p>2.1. Komisioni nga paragrafi 2 i këtij neni është në përbërje nga:</p> <p>2.1.1.doktori i mjekësisë ose specialist i mjekësisë familjare;</p> <p>2.1.2.oftalmologu;</p> <p>2.1.3.psikiatri/neuropsikiatri;</p> <p>2.1.4.neurologu/neuropsikiatri;</p> <p>2.1.5.psikologu;</p> <p>2.1.6 otorinolaringologu.</p> <p>2.2. analizat laboratorike – hemogrami, glikemia, urina.</p> <p>3. Në certifikatë plotësohet kodi përkatës, me shifra dhe me shkronja, për kufizimet dhe korigjimet, paraparë me akte juridike të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Ministrisë së Punëve të Brendëshme.</p> <p style="text-align: center;">Neni 8 Institucionet e autorizuara shëndetësore</p>	<p>examination by the medical commission and laboratory analysis.</p> <p>2.1. Commission from paragraph 2 of this Article has the following composition:</p> <p>2.1.1. doctor of medicine or specialist of family medicine;</p> <p>2.1.2. ophthalmologist;</p> <p>2.1.3. psychiatrist / neuropsychiatrist;</p> <p>2.1.4. neurologist / neuropsychiatrist;</p> <p>2.1.5. psychologist.</p> <p>2.1.6. Othorino-laringologist.</p> <p>2.2. laboratory analysis – hemogram, glycaemia, urine.</p> <p>3. In the certificate is marked the relevant code, in digits and in letters, on the restrictions and corrections, foreseen with legal acts of the Ministry of Infrastructure and Ministry of Internal Affairs.</p> <p style="text-align: center;">Article 8 Authorized health institutions</p>	<p>pregleda od strane lekarske komisije i laboratorijskih analiza.</p> <p>2.1. Komisija iz stava 2. ovog člana je u sastavu:</p> <p>2.1.1. doktor medicine ili specijalista porodične medicine;</p> <p>2.1.2. oftamolog;</p> <p>2.1.3. psihijatar/ neuropsihijatar;</p> <p>2.1.4. neurolog/neuropsihijatar;</p> <p>2.1.5. psiholog.</p> <p>2.1.6. Othorino-laringologist</p> <p>2.2. laboratorijske analize – hemogram, glikemija, urin.</p> <p>3. Na uverenju se popunjava odgovarajuća šifra, brojevima i slovima, o ograničenjima i ispravkama, koja su predviđena pravnim aktima Ministarstva infrastrukture i Ministarstva unutrašnjih poslova.</p> <p style="text-align: center;">Član 8 Ovlašćene zdravstvene institucije</p>
---	---	--

<p>Certifikata shëndetësore lëshohet nga subjekti juridik i licencuar nga Ministria e Shëndetësisë, gjegjësisht institucioni përkatës shëndetësor i licencuar nga Ministria e Shëndetësisë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 9 Vlefshmëria e certifikatave</p> <p>Vlefshmëria e certifikatave shëndetësore është 3 (tri) vite.</p> <p style="text-align: center;">Neni 10 Shtojcat</p> <p>1. Shtojca e cila i është bashkangjitur këtij Udhëzimi Administrativ është pjesë përbërëse e tij:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. Shtojca 1: Përkufizimet e standardeve minimale të aftësisë fizike dhe mentale për ngasje të automjeteve.</p> <p style="text-align: center;">Neni 11 Dispozitat shfuqizuese</p> <p>1.Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi administrativ shfuqizohet dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr.04/2013 Certifikatat shëndetsore si në vijim:</p>	<p>The health certificate is issued by a legal entity licensed by the Ministry of Health, respectively namely the relevant health institution licensed by the Ministry of Health.</p> <p style="text-align: center;">Article 9 Validity of certificates</p> <p>The validity of health certificates is 3 (three) years.</p> <p style="text-align: center;">Article 10 Annexes</p> <p>1. The annex attached to this Administrative Instruction is an integral part of this AI:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. Annex 1: Definitions of minimum standards of physical and mental skills for driving the vehicle.</p> <p style="text-align: center;">Article 11 Repealing provisions</p> <p>1. Entry into force of this Administrative Instruction shall repeal the provisions of Administrative Instruction No. 04/2013 on health certificates, as follows:</p>	<p>Lekarsko uverenje izdaje pravni subjekat licenciran od strane Ministarstva zdravstva, odnosno odgovarajuća zdravstvena institucija licencirana od strane Ministarstva zdravstva.</p> <p style="text-align: center;">Član 9 Važnost uverenja</p> <p>Važnost lekarskih uverenja je 3 (tri) godine.</p> <p style="text-align: center;">Član 10 Aneksi</p> <p>1. Aneks koji je priložen ovom Administrativnom uputstvu je njegov sastavni deo:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. Aneks 1: Definicije minimalnih standarda fizičke i mentalne sposobnosti za vožnju motornih vozila.</p> <p style="text-align: center;">Član 11 Odredbe o stavljanju van snage</p> <p>1. Stupanjem na snagu ovog Administrativnog uputstva ukidaju se odredbe Administrativnog uputstva br. 04/2013 zdravstveni sertifikati, kao u nastavku:</p>
--	--	--

<p>1.1.neni 5, paragrafi 3 dhe nënparagrafi 3.1;</p> <p>1.2.neni 8, paragrafi 3, nënparagrafët:3.1dhe 3.2 .</p> <p style="text-align: center;">Neni 12 Hyrja në fuqi</p> <p>Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Kryeministri i Republikës së Kosovës dhe publikohet në Gazetën Zyrtare.</p> <p style="text-align: center;">Ramush HARADINAJ</p> <hr style="width: 20%; margin: auto;"/> <p style="text-align: center;">Kryeministër i Republikës së Kosovës</p> <p style="text-align: right;">26 prill 2018</p>	<p>1.1. Article 5, paragraph 3 and subparagraph 3.1;</p> <p>1.2. Article 8, paragraph 3, subparagraphs: 3.1 and 3.2.</p> <p style="text-align: center;">Article 12 Entry into force</p> <p>This Administrative Instruction shall enter into force seven (7) days after signature of Kosovo and is published to the Official Gazette.</p> <p style="text-align: center;">Ramush HARADINAJ</p> <hr style="width: 20%; margin: auto;"/> <p style="text-align: center;">Prime minister of the Republic of Kosovo</p> <p style="text-align: right;">26 April 2018</p>	<p>1.1. član 5. stav 3. i tačka 3.1;</p> <p>1.2. član 8. stav 3. tačke: 3.1 i 3.2.</p> <p style="text-align: center;">Član 12 Stupanje na snagu</p> <p>Ovo Administrativno uputstva stupa na snagu sedam (7) dana potpisivanja istog od strane premijera Republike Kosovo i njegovog objavljivanja u Sluzbenom Listu.</p> <p style="text-align: center;">Ramush HARADINAJ</p> <hr style="width: 20%; margin: auto;"/> <p style="text-align: center;">Premijer Republike Kosovo</p> <p style="text-align: right;">26 april 2018</p>
--	--	--

SHTOJCA 1

PËRKUFIZIMET E STANDARDEVE MINIMALE TË AFTËSISË FIZIKE DHE MENTALE PËR NGASJE TË AUTOMJETEVE MOTORIKE

1. Për qëllim të kësaj shtojce, shoferët janë klasifikuar në dy grupe:

1.1. Grupi 1: shoferët e automjeteve të kategorive A, A1, A2, AM, B, B1 dhe BE.

1.2. Grupi 2: shoferët e automjeteve të kategorive C, CE, C1, C1E, D, DE, D1 dhe D1E.

1.3. Legjislacioni kombëtarë mund përcaktojë që dispozitat e dhëna në Shtojcën për shoferët e Grupit 2 të aplikohen për shoferët e automjeteve të kategorisë B duke përdorur patentat e tyre të shoferit për qëllime profesionale (taksitë, auto-ambulancat etj).

2. Ngjashëm, aplikuesit për patentën e parë të shoferit apo për vazhdimin e patentë shoferit janë të klasifikuar në grupin të cilit i takojnë pas marrjes apo vazhdimit të patentit.

EKZAMINIMET MJEKËSORE

3. Grupi 1: Aplikantëve do të iu kërkohet t'i nënshtrohen kontrollit mjekësor, nëse bëhet e qartë, gjatë përfundimit të formaliteteve të nevojshme, ose gjatë testeve të cilëve ata duhet të iu nënshtrohen para marrjes së një patentë shoferi, ata kanë një ose më shumë aftësi të kufizuara shëndetësore të përmendura në këtë Shtojcë.

4. Grupi 2: Aplikantët do t'i nënshtrohen ekzaminimeve mjekësore para lëshimit të patentë shoferit dhe pas kësaj, shoferët do të kontrollohen në përputhje me sistemin e ekzistues kombëtarë në shtetin anëtar të vendbanimit të zakonshëm, çdo herë kur vazhdohet patentat e tyre.

5. Standardet e vendosura nga shtetet anëtare për lëshimin ose vazhdimin e mëtejshëm të patentë shoferëve, mund të jenë më të rrepta se ato të përcaktuara në këtë shtojcë.

Të pamurit

6. Të gjithë aplikantët për patentë shofer do t'i nënshtrohen një ekzaminim të duhur për të siguruar që ata kanë mprehtësi të duhur të të pamurit për drejtimin e automjeteve motorike. Aty ku ka arsye për të dyshuar se shikimi i aplikantit është i mjaftueshëm, ai/ajo do të ekzaminohen nga një autoritet kompetent mjekësorë. Gjatë ekzaminimit, një kujdes i veçantë do të kushtohet, veçanërisht për sa vijon: mprehtësisë së të pamurit, fushës së të pamurit në muzg, djeshmërisë ndaj shkëlqimit

verbues dhe kontrastit, diplopië dhe funksioneve tjera, mprehtësisë së të pamurit që mund të komprometojnë ngasje të sigurtë.

Për shoferët e grupit 1, Certifikimi mjekësor mund të merret parasysht në "raste të veçanta", kur standardi i fushës së mprehtësisë së të pamurit ose standardi i mprehtësisë së të pamurit -nuk mund të plotësohet, në raste të tilla shoferi duhet t'i nënshtrohet- ekzaminimit mjekësorë nga një autoritet kompetent mjekësorë për të dëshmuar se nuk ka asnjë dëmtim tjetër të funksionit mprehtësisë së të pamurit, duke përfshirë shkëlqimin verbues, ndjeshmërinë ndaj kontrastit dhe të pamurit në muzg. Shoferi apo aplikanti gjithashtu duhet të i nënshtrohet një testi pozitiv praktik të kryer nga institucionet e autorizuar shëndetësore.

Grupi 1:

6.1. Aplikuesit për patentë shofer ose për ripërtërirjen e patentit të tillë duhet të kenë mprehtësinë binokulare të të pamurit, nëse është e nevojshme me lente korrigjuese, të paktën 0,5 gjatë përdorimit të dy syve së bashku. Për më tepër, fusha horizontale, fusha vizive horizontale duhet të jetë së paku 120 gradë. Vazhdimi i kësaj fushe duhet të jetë së paku i mundshëm 50 gradë majtas dhe djathtas dhe 20 gradë lartë dhe poshtë. Nuk duhet të ketë defekte të pranishme në një rreze prej 20 gradë në qendër të fushës vizive. Kur një sëmundje progresive në sy të jetë diagnostifikuar ose deklaruar, patentë shoferi mund të lëshohet ose vazhdohet vetëm nëse aplikuesit i nënshtrohet një ekzaminimi ose trajtimi në një institucion kompetent mjekësorë.

6.2. Aplikuesit për patentë shofer, ose për vazhdimin e një patenti të tillë, nëse kanë humbje totale funksionale të shikimit në njërën sy, ose të cilët përdorin vetëm një sy (p.sh. në rastin e diplopië) duhet të kenë një mprehtësi vizuale prej së paku 0.5 nëse është e nevojshme me lente korrigjuese. Autoriteti kompetent mjekësorë duhet të vërtetojë se kjo gjendje e shikimit monokular ka ekzistuar për një kohë mjaft të gjatë për të lejuar përshtatjen dhe se fusha e shikimit në këtë sy i përmbushë kërkesat e përcaktuara në paragrafin 6. 3.

6.3. Pas çdo diplopije të zhvilluar në kohët e fundit, ose pas humbjes së shikimit në një sy, duhet të ketë një periudhë të duhur për përshtatje (për shembull gjashtë muaj), gjatë së cilës ngasja nuk lejohet. Pas kësaj periudhe, ngasja lejohet vetëm pas një mendimi të favorshëm nga ekspertët mjekësorë adekuat.

Grupi 2:

6.4. Aplikuesit për patentë shofer ose për vazhdimin e patentës duhet të kenë një mprehtësi të pamurit, nëse është e nevojshme me lente korrigjuese, së paku 0.8 në syrin më të mirë dhe së paku 0,1 në syrin më të dobët. Nëse lentet korrigjuese përdoren për të arritur vlerat e 0,8 dhe 0,1, mprehtësia minimale (0,8 dhe 0,1) duhet të arrihet ose me korrigjim me anë të syzeve me

një fuqi që nuk kalon dioptrinë plus tetë, ose me ndihmën e lenteve korrigjuese. Korrigjimi duhet të tolerohet mirë.

Për më tepër, Fusha vizive horizontale vizuale me të dy sytë duhet të jetë së paku 160 gradë, vazhdimi i kësaj fushe duhet të jetë së paku i mundshëm 70 gradë majtas dhe djathtas; dhe 30 gradë lartë dhe poshtë. Nuk duhet të ketë defekte të pranishme brenda një rreze të 30 gradëve qendrore. Patentë shoferi nuk do të lëshohen ose vazhdohen për aplikuesit ose shoferët që vuajnë nga ndjeshmëria e dëmtuar ndaj kontrastit ose nga diplopia. Pas një humbje të konsiderueshme të shikimit në një sy, duhet të ketë një periudhë të duhur të përshtatjes (për shembull gjashtë muaj), gjatë së cilës subjekti nuk është i lejuar të ngasë. Pas kësaj periudhe, ngasja lejohet vetëm pas një mendimi të favorshëm nga ekspertët për shikim dhe ngasje.

DËGJIMI

7. Patentat e shoferit mund të lëshohen ose vazhdohen për aplikuesit ose shoferët në Grupin 2 bazuar në mendimin e autoriteteve kompetente mjekësore; kujdes i veçantë do të ndërmerret gjatë ekzaminimeve mjekësore të fushës për kompensim.

PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA LOKOMOTORE

8. Patentat e shoferit nuk do të lëshohen ose vazhdohen për aplikuesit ose shoferët që vuajnë nga ankesat apo anomalitë e sistemit lokomotor të cilat e bëjnë atë të rrezikshëm për të ngasur një automjet.

Grupi 1:

8.1. Patentat e shoferit që i nënshtrohen kufizimeve të caktuara, nëse është e nevojshme, mund të iu lëshohen aplikuesve apo vozitësve me aftësi të kufizuara fizike pas dhënies të një mendimi nga një autoritet kompetent mjekësorë. Ky mendim duhet të bazohet në një vlerësim mjekësorë të ankesës apo anomalive në fjalë dhe kur është e nevojshme, me një test praktik. Gjithashtu duhet të tregohet se çfarë lloji i modifikimit në veturë është i nevojshëm dhe nëse shoferi duhet të jetë i pajisur me një pajisje ortopedike, për aq sa testimi i aftësive dhe sjelljeve tregon se me një pajisje të tillë ngasja nuk do të shfaq rrezik.

8.2. Patentat e shoferit mund të lëshohen ose vazhdohen për çdo aplikant që vuan nga një ankesë progresive, me kusht që personi me aftësi të kufizuara ekzaminohet rregullisht për të kontrolluar se personi është ende i aftë për drejtimin e veturës në mënyrë plotësisht të sigurtë. Kur aftësia e kufizuar është statike, patentë shoferat mund të lëshohen ose vazhdohen pa nënshtrimin e aplikuesit ndonjë ekzaminimi të rregullt mjekësorë.

Grupi 2:

8.3. Autoriteti kompetent mjekësorë do të merr parasysht risqet shtesë dhe rreziqet e përfshira në ngasjen e automjeteve të mbuluara nga përkufizimi i këtij grupi.

SËMUNDJET KARDIOVASKULARE

9. Gjendjet apo sëmundjet kardiovaskulare mund të çojnë në një dëmtim të papritur të funksioneve cerebrale, të cilat paraqesin rrezik për sigurinë rrugore. Këto kushte paraqesin bazë për vendosjen e kufizimeve të përkohshme ose të përhershme në ngasjen e makinës.

9.1 Për gjendjet e mëposhtme kardiovaskulare, patentat e shoferit mund të lëshohen ose vazhdojnë për aplikantët ose shoferët në grupet e indikuara, vetëm pasi gjendja të jetë trajtuar në mënyrë efektive dhe në bazë të autorizimit mjekësorë kompetent dhe nëse është i nevojshëm një vlerësim i rregullt mjekësorë:

9.1.1. bradi-aritmia (sëmundje e nyjes dhe çrregullime të përçueshmërisë) dhe tahi-aritmia (aritmia supraventrikulare dhe ventrikulare), me histori të sinkopës ose epizode të sinkopës për shkak të gjendjeve të aritmisë (aplikohet tek grupi 1 dhe 2);

9.1.2. bradi-aritmia: sëmundje e nyjes sinusale dhe çrregullime të përçueshmërisë me bllok atrioventrikular të shkallës së dytë (AV) Mobitz II, shkalla e tretë AV bllok ose bllok të degës të grupit të alternuar (aplikohet tek grupi 2 vetëm);

9.1.3. tahi-aritmia (aritmia supraventrikulare dhe ventrikulare) me — sëmundjet strukturale të zemrës dhe tahikardi të qëndrueshme ventrikulare (VT), (aplikohet tek grupet 1 dhe 2), ose - VT polimorfe e paqëndrueshme, tahikardi ventrikularë e qëndrueshme ose me shenjë të defibrilimit (aplikohet vetëm tek grupet 2);

9.1.4. simptomatika e anginës (aplikohet tek grupi 1 dhe 2);

9.1.5. implantimi i përhershëm i pacemaker-it ose zëvendësimi (aplikohet vetëm tek grupi 2);

9.1.6. Implantimi i defibrilatorit ose zëvendësimi i tij. (aplikohet tek grupi 1 dhe grupi 2 i defibrilatorit ose zëvendësimi shok defibrilator i përshtatshëm apo i papërshtatshëm (aplikohet vetëm tek grupi 1);

9.1.7. sinkopa (një humbje kalimtare e vetëdijes dhe e tonusit posturall, që karakterizohet me sulm të shpejtë, kohëzgjatje të shkurtë dhe marrje spontane të vetës, për shkak hipoperfusionit global cerebral, me origjinë të supozuar refleksive, të shkakut të panjohur, pa dëshmi të ndonjë sëmundje ekzistuese të zemrës), (aplikohet tek grupi 1 dhe 2);

- 9.1.8. sindroma akute koronare (aplikohet tek grupi 1 dhe 2);
- 9.1.9. angina stabile nëse simptomat nuk shfaqen gjatë ushtrimeve të lehta (aplikohet tek grupi 1 dhe 2);
- 9.1.10. ndërhyrja koronare perkutane (NKP), (aplikohet tek grupi 1 dhe 2);
- 9.1.11. operacionet koronare të implantimit të “by - pass” (urëzimit), arterial (OKIBA), (aplikohet te grupi 1 dhe 2), “TIA” atak/sulm iskemik tranzitor/sulmet kalimtare ishemike (SKI), (aplikohet tek grupi 1 dhe 2);
- 9.1.12. stenoza të sinjifikante të arterieve karotide (aplikohet vetëm tek grupi 2);
- 9.1.13. diametri maksimal i aortës që tejkalon 5,5 cm “ose me simptomatologji të aneurismës së aortës (aplikohet vetëm tek grupi 2);
- 9.1.14. Insuficiencë (pamjaftueshmëri) e zemrës - stadet e insuficiencës së zemrës sipas NYHA I, I dhe III e Zemrës New York (NYHA) I, II, III (aplikohet vetëm në grupin 1), - NYHA I dhe II nëse fraksioni i ejectionit të ventrikulit të majtë është së paku 35 % (aplikohet vetëm në grupin 2);
- 9.1.15. transplantimi i zemrës (aplikohet tek grupi 1 dhe 2);
- 9.1.16. pajisje për ndihmë ardiac “Assist device” (aplikohet vetëm tek grupi 1);
- 9.1.17. operacionet e valvulës së zemrës (aplikohet tek grupi 1 dhe 2);
- 9.1.18. hipertensioni malinjë (ngritja e tensionit sistolik të gjakut ≥ 180 mmHg ose tension diastolik i gjakut ≥ 110 mmHg i shoqëruar me dëmtim të pashmangshëm apo progresiv të organit), (aplikohet tek grupi 1 dhe 2);
- 9.1.19. tensioni i gjakut i grupit III (tensioni diastolik i gjakut ≥ 110 mmHg dhe/se tensioni sistolik i gjakut ≥ 180 mmHg) pa dëmtim të organeve! (aplikohet vetëm tek grupi 2);
- 9.1.20. sëmundjet kongjenitale të zemrës (aplikohet tek grupi 1 dhe 2);
- 9.1.21. kardiomiopatia hipertrofike nëse është pa sinkopë (aplikohet vetëm tek grupi 1);
- 9.1.22. Sindroma e Intervqalit QT të zgjatur me sinkopa, Torsadat (“Torsade des pointes”) apo QTc > 500 ms (aplikohet vetëm tek grupi Grupi 1 dhe 2 1).

9.2. Patentët e shoferit nuk do të lëshohen ose vazhdojnë për aplikuesit apo shoferët në grupet e indikuara për gjendjet kardiovaskulare në vijim:

9.2.1. implantet apo defibrilator (aplikohen vetëm tek grupi 2);

9.2.2. sëmundjet periferale vaskulare — aneurizma torakale dhe abdominale kur diametri maksimal aortik është i tillë, që ka predispozita për risk të madh të rupturës dhe si pasojë një ngjarje të papritur të paaftësisimit (aplikohet tek grupi 1 dhe 2);

9.2.3. Pamjaftueshmëria/insuficienca e zemrës;

— NYHA IV (aplikohet vetëm tek grupi 1),

— NYHA III dhe IV (aplikohet vetëm tek grupi 2);

9.2.4. Pajisjet për ndihmëse për zemër – ”Medical assist device” (aplikohet vetëm tek grupi 2);

9.2.5. Sëmundjet valvulare të zemrës me —regurgitim aortal, stenoze të aortes, regurgitim mitral apo stenoze mitrale, aftësia funksionale është vlerësuar të jetë NYHA IV ose nëse ka pasur ndonjë epizodë sinkope (aplikohet vetëm tek grupi 1);

9.2.6. Sëmundjet valvulare të zemrës në Stadin NYHA III ose IV me fraksion ejektues, nën 35 %, të stenzës mitrale dhe hipertensionit të rëndë pulmonal ose me stenoze të rëndë të diagnostifikuar me ekokardiografi dhe stenoze të rëndë aortale që shkakton sinkopë, përveç stenzave plotësisht të rënda simptomatike aortale nëse janë plotësuar kërkesat e ushtrimit të testit të tolerancës (aplikohet vetëm tek grupi 2);

9.2.7. Kardiomiopati të strukturale ose edhe kardiomiopati të me pasoja në përçueshmërinë e sinjalit elektrik — kardiomiopatia hipertrofike me histori të sinkopës ose kur janë prezente dy apo më tepër gjendje: ventrikuli i majtë (LV) trashësia e murit > 3 cm, tahikardia e paqëndrueshme ventrikulare, historia e vdekjeve të papritura në familje (tek familjarët e nivelit të parë), nëse nuk ka përgjigje adekuate (nëse nuk ka rritje ose nëse ka rënje) të tensionit arterial gjatë provës ushtrimore “ergometri-stresstest” (aplikohet vetëm tek grupi 2);

9.2.8. sindromi i intervalit QT të zgjatur me sinkopë, torsadat “torsades des pintes ” dhe QTc > 500 ms (aplikohet vetëm tek grupi 2);

9.2.9. Sindromi Brugada me sinkopë apo vdekje të papritur kardiake në anamnezën familjare! (aplikohet tek grupi 1 dhe 2).

9.3 Patentë shoferët mund të lëshohen ose vazhdohen në raste të jashtëzakonshme, nëse një gjë e tillë është arsyetuar me një mendim kompetent mjekësorë dhe i nënshtrohet një vlerësimi mjekësorë që personi është ende i aftë të ngasë veturën në mënyrë të sigurtë duke marrë parasysh efektet e gjendjes mjekësore.

9.4 Kardiomiopati të tjera :Rreziku nga ngjarjet e papritura të paaftësisimit do të vlerësohen tek aplikantët apo shoferët me kardiomiopati të përshkruara mirë kardiomiopatia aritmogjene e ventrikulit të djathtë, kardiomiopatia me rënje të funksionit të kompliancës-kardiomiopatia “ Non compaction” , tahikardia ventrikulare polimorfe katekolaminergjike dhe sindromi e intervalit të shkurtuar QT ose kardiomiopati të reja që mund të diagnostifikohen. Kërkohet një vlerësim i kujdesshëm specialistik. Karakteristikat prognostike të secilës prej kardiomiopative nga momenti i diagnostifikimit duhet të mirren në konsideratë.

